



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KESHILLI I MINISTRAVE**

**VENDIM**

**Nr. 267 datë 12.04.2012**

**“PËR**

**“ LLOJET, MËNYRËN E SHKËMBIMIT DHE TË PËRPUNIMIT TË  
INFORMACIONIT DHE TË DHËNAVE STATISTIKORE TË KËRKUARA NGA  
AGJENCIA E NGA STRUKTURAT SHTETËRORE PËRGJEGJËSE, NË NIVEL  
QËNDROR DHE VENDOR”**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 37, të ligjit nr.10347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” me propozim të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave:

**VENDOSI :**

1. Monitorimi i treguesve të mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, realizohet në nivel qendror dhe vendor, dhe ka për qëllim mundësimin e të dhënave për hartimin e rekomandimeve dhe politikave për mbështetjen e programeve të mbrojtjes së të drejtave të fëmijës.

2. Ministrinë e Linjës/institucionet qendrore dërgojnë pranë ASHMDF-së të dhënat statistikore të mbledhura dhe përpunuara bazuar në formularët bashkëlidhur këtij vendimi dhe periodicitetit të përcaktuar në to.

3. Strukturat e Ministrive të Linjës në nivel vendor dërgojnë pranë Njesisë për të Drejtat e Fëmijës në qark, të dhënat statistikore për rajonin, bazuar në formularët bashkëlidhur këtij

vendimi dhe periodicitetit të përcaktuar në to. Njësia për të Drejtat e Fëmijës në qark përpunon të dhënat e të gjitha institucioneve në nivel vendor dhe i dërgon pranë Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës (ASHMDF) brenda muajit pasardhës.

4. Instituti i Statistikës, me kërkesë të ASHMDF-së dërgon pranë ASHMDF-së të dhënat statistikore të përcaktuara, në formularët bashkëlidhur këtij vendimi.

5. ASHMDF-ja mbledh dhe përpunon të dhënat statistikore të dërguara nga strukturat dhe institucionet e parashikuara në pikat 2,3,4 të këtij vendimi dhe pasi i vlerëson, harton raporte periodike për realizimin e qëllimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi me synim përmirësimin e respektimit të mbrojtjes së të drejtave të fëmijës.

6. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës dërgon pranë Sektorit të Statistikës të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të dhënat e mbledhura.

7. Ngarkohet Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës për mbikqyrjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E M I N I S T R I**

**SALI BERISHA**